



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER  
NJËSIA E PROKURIMIT



Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Fier, më 11.03.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale kirurgjikale MM2”**, Marrëveshje Kuadër -  
me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

---

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Kodet CPV: - 33140000-3 (materiale mjekimi te konsumeshme)

**VLERA E FONDIT LIMIT: 25 830 777,50** *(njëzet e pesë milion e tetëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë) lekë pa tvsh.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitalit Rajonal “Memorial” Fier” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 .;
- b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kriteri Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

---

### **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**Kriteri 2.2.1** Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë **3 (tre) viteve** te fundit (**2021, 2022, 2023**), ku vlera e xhiros **për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se 25 000 000** lekë (pra kjo vlerë e xhiros minimale vjetore nuk tejkalon vlerën e parashikuar të kësaj kontrate).

**Argumentimi per Kriterin 2.2.1:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa ”b”, për procedurat me objekt mallra me fond limit ndermjet kufirit te ulet dhe te larte monetar, siç është rasti i kësaj procedure, maksimumi i xhiros vjetore te kerkuar nuk duhet te tejkaloje vlerën e parashikuar të kësaj kontrate.

### **Kapaciteti teknik:**

**Kriteri 2.3.1** Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit , në një vlerë jo më të ulët se **10 000 000 lekë** (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit , nuk tejkalon 40% të vlerës së parashikuar të kësaj kontrate).

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik per permbushjen me sukses të kontratës, ku e shënohet vlera, afati i përfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi kriteri 2.3.1:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën e cila nuk tejkalon 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimin të tij dhe për të pasur sigurinë

që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

**Kriteri 2.3.2:** Ofertuesi të paraqesë Autodeklarate mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese) për secilin artikull, për plotësimin e afatit të skadencës së tyre, si dhe respektimit të specifikimeve teknike që oferton. Shënim: Data e skadencës për materialet mjekësore të konsumit objekt prokurimi, në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1 vit.

**Argumentimi për kriterin 2.3.2:** Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

**Kriteri 2.3.3 :** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregëtim të pajisjeve mjekësore.

**Argumentimi kriteri 2.3.3 :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe Në Ligjin Nr. 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore” neni 21 i tij.

**Kriteri 2.3.4 :** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” dhe nëse operatori ekonomik ofertues është prodhues i artikujve të ofruar duhet të paraqesë çertifikatën SSH EN ISO 13485:2016 “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, ose EN ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” për tregëtim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Kriteri 2.3.5** Operatori ekonomik ofertues në rastet kur nuk është prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet të paraqesë autodeklarate që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është konform standarteve të cilësisë ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose EN ISO 13485 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose SSH EN ISO 13485 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi për kriterin 3.3.4 dhe 2.3.5 :** Në bazë të nenit 79/1, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 40 si dhe 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikatën të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe

kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;b) efikasitetit të energjisë;c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

**Kriteri 2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autodeklarate për pajisjet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC (ose MDR) ose IVD 98/79 EC (të përditësuar), ose EU 2016/425 (të përditësuar) ose FDA ose (EU) 2017/745, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.

**Argumentimi për kriterin 2.3.6:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3.4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se Certifikatat perkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

**Kriteri 2.3.7 :** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të lëshuar nga firma prodhuese ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi /MAH/ për Shqipërinë (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregtojë materialet mjekesore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave; dhe origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara.

**Argumentimi për kriterin 2.3.7 :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku është e cituar: Pika 5. *”Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore perkatëse, për shkak që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.* Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t'u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës

**Kriteri 2.3.8** Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten Katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet

te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor **(te markuara sipas artikullit)** te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

**Argumentimi kriterin 2.3.8:** Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose;

**Kriteri 2.3.9** Operatori ekonomik duhet te paraqese Oferten Teknike, per artikujt e kerkuar ne forme table, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet.

**Argumentimi për kriterin 2.3.9: Ky kriter vendoset bazuar** në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Nr.	Artikulli	Specifikime teknike
	<b>Materiale mjekimi per Anestezi - reanimacion</b>	
1	Kanjule intravenoze	14G , me valvol
2	Kanjule intravenoze	16G , me valvol
3	Kanjule intravenoze	18G , me valvol
4	Kanjule intravenoze	20G , me valvol
5	Kanjule intravenoze	22G , me valvol
6	Kanjule intravenoze	24G, me valvol
7	Age mielogramme me doreze	Tip troakar, 16-18G, L=75-90 cm, me doreze regjistruese

8	Age spinale e zakonshme	22G - 26G, L=7-9 cm
9	Age spinale atraumatike	Pencil point; 22G - 26G; L=7-9cm
10	Kateter zgjatues arterial	Zgjatues 120-150cm
11	Kateter zgjatues venoz	Zgjatues 120-150cm
12	Ventil tre-rruges	
13	Ventil tre-rruges me zgjatues	Tub 10-25 cm gjatesi
15	Kateter Foley 2-rruge	Silikon Foley Ped-adult 2-rruge 12G-20G
16	Kateter Foley 3-rruge	Silikon Foley Ped-adult 3-rruge
18	Sonde gastrike	
19	Sonde rektale	
21	Qese urine	2000ml, me valvol
24	Set aspirimi kanjule me tub	1.8 deri 2.5 m+kanjule 26X6 mm
25	Kanjule trakestomie	4, 4.5, 5.5, 6 mm me ballon
26	Kanjule trakeostomie 100% silikon	7,7.5,8,8.5 mm me ballon
27	Gjuheza per laringoskop me kamera	Paketim steril, material polimer optik, Nr.2,3,4
28	Age biopsie semi automatic	14G-100mm
29	Age localization mamaro	Type Z 20G-50mm
31	Kateter urinar	2 rruges, 12 ch, balon 10 ml
32	Kateter urinar	2 rruges, 16 ch, balon 30 -50 ml
33	Kateter urinar	2 rruges,20 ch, balon 30-50 ml
34	Kateter urinar	2 rruges, 18 ch, balon 30-50 ml
35	Kateter urinar	2 rruges, 14 ch, balon 30-50 ml
36	Kateter urinar	3 rruges 12-20 ch, balon 30-50 ml
37	Sonde blakemore	Nr. 16, 20
38	Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis	Me perberje polivinil acetat i hidroksiluzuar, kompresim i dyfisht, pa fibra, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 10 cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2.5 cm

39	Sfungjer Nazal pa fill me tub ajrimi	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, trashesi 1.5 cm dhe lartesi 3 cm
40	Sfungjer Nazal me fill	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2 cm
41	Splint Intranazal Silikoni	Splint Intranazal Silikoni me tub ajrimi
	<b>Shiringa, Age</b>	
42	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,
43	Shiringa 20cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,
44	Shiringa 10cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 21 G , 3 pjese,
45	Shiringa 5cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 22 G , 3 pjese,
46	Shiringa 2cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 23G , 3 pjese,
47	Shiringa insuline	Sterile, tre pjeseshe, me Age 26G
48	Age 18G	sterile
49	Age 20G	sterile
50	Age 21G	sterile
51	Age 23G	sterile
52	Age 25G	sterile
53	Age flutur 18G	sterile
54	Age flutur 20G	sterile
55	Age flutur 22G	sterile
56	Age flutur 24G	sterile
57	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile me gryke hinke
	<b>Materiale nje perdorimeshe per kirurgji</b>	
58	Perparese kirurgu sterile	Perparese kirurgu me peshe jo me pak se 55 g / cm <sup>2</sup> , me fundin e kraheve 8 cm te thurura , me jake rrethore, me kemishe me materjal PP , e sterilizuar , me permasat L ; XL ; XXL. ngjyre jeshile ose blu

59	Perparese vizitoresh	Perparese vizitoresh me peshe jo me pake se 20 gr , me menqe elastike dhe jake rrethore
60	Maske kirurgjikale	Cope e pathurur me 3 shtresa, celuloze , poliester , fiber , koficenti i filtrimit $\geq 99\%$ , me pershtates per hunden dhe lidhese , dimesionet 90 mm x 180 mm , pesha 2.8 gr
61	Kapele kirurgu	Cope e pathurur me peshe jo me pak se 25 gr.m <sup>2</sup> , me lidhese poshte qafes, pa latex.
62	Kapuc per infermjere	Cope e pathurur me peshe jo me pak se 25 gr.m <sup>2</sup> me fund elastik , pa latex.
63	Qese per veshje kepucesh	Qese PVC, me mbyllje elastike
65	Beze kirurgjikale aktive 7.5 cm x 7.5 cm	Cope e thurur, me thithje te shpejte per plage, me perberes polyakrylate (SAP) me veshje celuloze and solucion ringer, 7.5 cm x 7.5 cm ose ekuivalent
66	Beze kirurgjikale sterile 75x90cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m <sup>2</sup> , me permasa te copes 75x90cm
67	Beze kirurgjikal sterile me vrime 200 x 250 cm	Cope e pathurur e veshur me polietilen, jo invazive, me peshe jo me pak se 35 gr/m <sup>2</sup> , me vrime rrethore , me diameter 10 cm , me buze adesive,me permasa te copes 200 x 250 cm
68	Beze kirurgjikale sterile me vrime 75x90cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m <sup>2</sup> , me vrime rrethore , diameter 5 cm , me buze adesive, me permasa te copes 75x90cm
69	Beze kirurgjikale sterile me vrime (100 x 150cm)	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m <sup>2</sup> , me vrime rrethore , me diameter 10 cm , me buze adesive, me permasa te copes 100 cm x 150 cm .
70	Beze me vazeline	Beze me pomade te thjeshte (vazeline te bardhe, estere acid yndyror digliceroli te karbonateve dhe bikarbonateve, dyll sintetik) e pershkueshme nga ajri dhe eksudati, me shtrese te trashe qe nuk fshihet dhe ne rast te eksudatit masiv, jo alergjike, efektive dhe per trajtim afatgjate. 7.5cm x10 cm ose ekuivalent
71	Beze hidroxhel	Beze e sfungjerte hidropolimere, hidroxheli me perberje poliure/poliuretan-poliuretan polimer, propilen glikol, me buze adezive poliakrilat. Permasa 15x15 cm;
	<b>Materiale qepes kirurgjikale</b>	
	<b>Sutura mendafshi</b>	
72	Silk -USP 1, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore



73	Silk -USP 0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore
74	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-35	me age 1/2 rrethore
75	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-35	age 1/2 rrethore
78	Silk -USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	age 1/2 rrethore
79	Silk -USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	age 1/2 rrethore prerese
80	Silk -USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore shpuese
81	Silk -USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore prerese
83	Silk -USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore shpuese
84	Silk -USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore prerese
85	Silk -USP6-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 16-20	me age 1/2 rrethore prerese
88	Silk -USP 1, Gjatesia fijes 70-90cm;	ligature pa age, 10 fije/pakete
89	Silk -USP 0, Gjatesia fijes 70-90cm;	ligature pa age, 10 fije/pakete
90	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm;	ligature pa age, 10 fije/pakete
91	Silk -USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm;	ligature pa age, 10 fije/pakete
92	Silk -USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm;	ligature pa age, 10 fije/pakete
93	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-35	me age 1/2 rrethore prerese
	<b>Sutura Sintetike te Absorbueshme</b>	
94	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 1; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensiononi i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore
95	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensiononi i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore
96	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 2- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensiononi i ageve 30-40	me age 1/2 rrethore
97	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 3- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensiononi i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore
98	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 4- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensiononi i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore
99	Poliglctin ose PGA , Coated-USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore
100	Poliglctin ose PGA , Coated-USP6-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore

101	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 2- 0; Gjatesia e fijes 2.5 m	me ligature pa age
102	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 3- 0; Gjatesia e fijes 2.5 m	me ligature pa age
103	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 0; Gjatesia e fijes 2.5 m	me ligature pa age
104	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 1; Gjatesia e fijes 2.5 m	me ligature pa age
105	Poliglctin ose PGA , Coated me absorbim te shpejte-USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-26	me age 1/2 rrethore
106	Poliglctin ose PGA , Coated me absorbim te shpejte-USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30 mm	me age 1/2 rrethore
107	Poliglctin ose PGA , Coated me absorbim te shpejte-USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30 mm	me age 1/2 rrethore
108	Polyglactine 910-USP 0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore
109	Polyglactine 910-USP2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40	me age 1/2 rrethore
110	Polyglactine 910-USP 3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore
111	Polydioxone-USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-35	me age 1/2 rrethore
112	Polydioxone-USP 3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore
113	Polydioxone-USP 4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore
114	Polydioxone-USP 5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore
115	Suture Sintetike e absorbueshme nga 90-110 dite, USP 3-0	Me perberje Glikolid, diaksanone dhe trimetilen karbonati,me luspa ne nje drejtim rreth gjithë trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 23cm, age 5/8, 27mm, taper point
116	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 2-0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithë trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 1/2, 26mm, taper point
117	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithë trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 3/8, 19mm, reverse cutting
118	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 3-0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithë trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 45cm, age 1/2, 17mm, taper point

119	Suture Sintetike e absorbueshme 180 dite, USP 0	Me perberje Kopolimer prej acidi glikolik dhe karbonat trimetileni, me luspa ne nje drejtim rreth gjithe trupit te fijes dhe me lak ne fund, gjatesi 60cm, age 1/2, 37mm, taper point
	<b>Suture Polipropileni</b>	
120	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore
121	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50 mm	1/2 rrethore shpuese
122	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 75-90cm; dimesnioni i ageve 40-50 mm	1/2 rrethore, cutting
123	Polypropylene-USP0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore
125	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore
126	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore. Shpuese
128	Polypropylene-USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30 mm	1/2 rrethore. Shpuese
129	Polypropylene-USP4-0, Gjatesia fijes 60-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore
130	Polypropylene-USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22 mm	1/2 rrethore. Shpuese
131	Polypropylene-USP 5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22 mm	1/2 rrethore. Shpuese
132	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 75cm; dimesnioni i ageve 30 mm	1/2 rrethore, cutting
133	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 75cm; dimesnioni i ageve 30 mm	1/2 rrethore, cutting
134	Polypropylene-USP3-0, Gjatesia fijes 75cm; dimesnioni i ageve 24 mm	3/8 rrethore, cutting
135	Polypropylene-USP3-0, Gjatesia fijes 45-50cm; dimesnioni i ageve 14-15 mm	age 3/8 rrethore, reverse cutting, slip point
136	Polypropylene-USP4 -0, Gjatesia fijes 45-50cm; dimesnioni i ageve 14-15 mm	age 3/8 rrethore, reverse cutting, slip point
	<b>Sutura PVDF</b>	
137	Monofilament PVDF, e pa absorbueshme; USP 6/0,	0.7 metric, reverse cutting, 12mm 3/8 circle, length 45 cm

138	Monofilament PVDF, e pa absorbueshme; 2+2 USP 6/0,	0.7 metric, reverse cutting, 12mm 3/8 circle, length 76 cm
139	Monofilament Sutura PVDF, e pa absorbueshme; USP 3/0	2 metric, straight cutting, 60mm straight, length 100 cm
140	Monofilament Sutura PVDF, e pa absorbueshme; USP 6/0	0.7 metric, reverse premium cutting, 12mm 3/8 circle, length 45 cm
141	Monofilament PVDF, e pa absorbueshme; USP 4/0,	1.5 metric, reverse premium cutting, 16mm 3/8 circle, length 45 cm
142	Monofilament PVDF, e pa absorbueshme; USP 3/0,	2 metric, fineline cutting, 25mm 3/8 circle, length 45 cm
143	Monofilament Sutura PVDF, e pa absorbueshme; USP 2/0	3 metric, A-cute Taper, 25mm 1/2 circle, length 90 cm
144	Monofilament Sutura PVDF e pa absorbueshme; 2/0	3 metric, Round bodied taper, 30mm 1/2 circle, length 76 cm
	<b>Sutura PVDF e verdhe</b>	
145	Monofilament PVDF I verdhe, e pa absorbueshme USP 3/0,	2 metric, reverse cutting, 24mm 3/8 circle, length 45 cm
146	Monofilament PVDF I verdhe e pa absorbueshme USP 2/0	3 metric, reverse cutting, 25mm 1/2 circle, length 76 cm
147	Monofilament PVDF I verdhe, e pa absorbueshme USP 4/0,	1.5 metric, A-cute taper, 20mm 1/2 circle, length 90 cm
148	Monofilament PVDF I verdhe, e pa absorbueshme USP 3/0,	2 metric, Round bodied taper, 16mm 1/2 circle, length 45 cm
	<b>Mesh kirurgjikal per hernia-laparaskopi.</b>	
150	Mesh polypropyleni - forme drejtkendore	Fije monofilament; pesha e meshes 80-90g/m2, siperfaqja jo me pak se 112cm2
151	Mesh e vogel	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe kopolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 150cm2
152	Mesh e madhe	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe kopolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 900cm2, porozitet > 75 mikron

153	MESH PVDF/PP	Mesh e perbere me dy komponente 88% PVDF dhe 12% polypropylene (PP) 10cm x15 cm ose ekuivalent
154	MESH PVDF	Mesh me monofilament PVDF per korrigjim kirurgjikal inkontinences urinare mikse ose nga sforcimi me teknike minimalisht invazive, 0.1 cm x 0.6 cm ose ekuivalent
155	MESH PVDF Hiatus	Mesh me monofilament PVDF per korrigjim kirurgjikal te hernies aksiale dhe paraezofageale, 0.7 cm x 12 cm
	<b>Te tjera materiale qepes kirurgjike</b>	
160	Stapler	Linear 30/60/90 mm
161	Stapler rrethor 25mm / 28mm / 31mm	Stapler nje-perdorimesh rrethor 28mm, gjatesia e boshtit 22 cm dhe me kapese 4.8mm ne forme drejtekendore, anvili te jete me mekanizem tilt
162	Stapler Endoskopie	Stapler njeperdorimesh i rikarikueshem, gjatesia e boshtit 16cm dhe 6cm, artikulacion +/-45 grade dhe me 11 pozicione
163	Stapler linear prerës	60-80 mm
164	Stapler per lekure	Te kete jo me pak se 35 kapese te gjera
165	Kartrixh per Stapler Endoskopie	Kartrixh i artikulluar me tre rrjeshta me lartesi te ndryshme (2;2.5;3mm dhe 3;3.5;4mm), 30mm;45mm;60mm
166	Aplikator automatik klipash	Medium
167	Elektroda, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut ne forme gershere	Elektroda, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm. Prerje (devaskularizimi i organeve), me maje te harkuar, thike te integruar te pavarur nga ngjitja, me buton aktivizimi ne elektrode
169	Elektroda njeperdorimeshe per tiroidektomi	Instrument ne per ngjitjen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm; te jete ne forme gershere; me maje te harkuar; gjatesia totale 18.8 cm; gjatesia e ngjitjes 16.5mm; gjatesia e prerjes 14.7mm

170	Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut , 23cm	Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut deri ne/perfshire 7 mm, 23cm. Prerje (devaskularizimi i organeve), i rrotullueshem 350 grade, gjatesi nofulle 20mm, prerje 18mm, me thike te integruar te pavarur nga ngjitja.
<b>Dezinfektante Mjekesore dhe Kirurgjikale</b>		
171	Dezinfektant instrumentash me baze Glutaraldehyde-Formaldehyde	Per dezinfektimin manual te instrumenteve kirurgjikale, perfshire endoskopet dhe fibroskopet. Te kete efekt baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral (perfshire HBV/HIV)Te furnizohet si komplet me solucion e pa - aktivizuar dhe aktivizuesin per perzierjen dhe perfimin e solucionit te gatshem per perdorim.Permbajtja: min. 2% glutaraldehyde, etj. Te furnizohet si solucion i gatshem per perdorim (max 5 litra / ene). Te kete referenca perdorimi nga firmat e njohura te endoskopeve dhe fibroskopeve
172	Solucion i koncentruar enzimatik	Per pastrimin e mbetjeve ne intrumentat mjekesore-kirurgjikale, vecanerisht endoskopet dhe instrumentat mjekesore dhe kirurgjikale me pjese te levizeshme dhe lumene te vegjel.Te kete baze enzimatiqe. Te furnizohet si koncentrat per tu holluar me uje ne masen 1-3% . Te jete efektiv per pune ne uje me temperature te zakonshme (~20°)
173	Drape dezinfektuese	Drape higjenike ter gatshme per perdorim, te imprenjuara me solucion pastrues dhe dezinfektues. Per pastrimin dhe dezinfektimin e siperfaqeve te vogla te pajisjeve dhe instrumentave mjekesore; 100-200 cope / kuti .

174	Detergjent	Dezinfektim të shpejtë dhe të vazhdueshme të të gjitha sipërfaqeve, plane sanitare, dysheme, dhe objekteve. Dezinfektanti përmban 10 % Didecildimetilammonio Cloruro dhe 2 % Isotiazolinone Magnesio Cloruro , përdoret duke u tretur 20 ml në 1 liter uje
175	Xhel shumëpërdorimsh	Per dezinfektimin e duarve te personelit mjekesor , Antiseptik i shpejte dhe efektiv, i gatshem për ta përdorur , pa nevojën përdorimin e ujit për shplarje. Te furnizohet në ene 1 - 3 liter te pajisura me dozator.
176	Chlorhexidine gluconate	4% chlorexidine gluconate; . Antiseptik me efekt baktericid, fungicid, antiviral . Për kirurgët për dezinfektimin e duarve , larja e plotë e pacientëve përpara ndërhyrjes kirurgjikale, i gatshem për ta përdorur
177	Peroksid Hidrogjeni 3%	Peroksid hidrogjeni 3% e vëllimit . Për përdorim të te plageve te jashtëme , i gatshëm për ta përdorur
178	Formaldehid	Solucion 35-40%
180	Benzalchonium chloride 10%	Benzalconium chloride 10%. Per dezinfektimin dhe pastrimin e sipërfaqeve. Efekt baktericid, mycobaktericid, antiviral.

### **Specifikime teknike te pergjithshme :**

Materialet e mjekimit duhet të përmbushin standartet CE ose CE sipas direktivës MDD/MDR 93/42 EEC. Ato duhet të jenë të markuara CE në momentin e lëvrimit të mallit.

Afati i skadencës: jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.

Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh.

Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësore detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DST të kësaj procedurë prokurimi.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**